

BASHKIA KOLONJË
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr.1152 prot
08.04.2020

Data:

Për: Operatorin ekonomik **InfoSoft Office SHPK me NIUS J62426002Q**

Adresa: Tiranë Kashar Koder Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.

Procedura e prokurimit: **Kërkesë për Propozim,Mallra**,prokurim me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-52964-03-04-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Blerje Kancelari dhe Tонера viti 2020** dhe kohëzgjatja e kontratës **nga nënshkrimi i kontratës** me përfundim në **31 / 12 / 2020** .

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik Adenis Kastrati PF

L51611004I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **1,663,890 (Njëmilione gjashtëqind e gjashtëdhjetë tremijë tetëqind e nëntëdhjetë) lekë pa Tvsh .**

(me numra dhe fjalë)

2. Operatori Ekonomik EUROPRINTY GROUP SHPK

L21621001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **1,650,000 (Njëmilione gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa Tvsh.**

(me numra dhe fjalë)

3. Operatori Ekonomik InfoSoft Office SHPK

J62426002Q

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera **1,911,267 (Njëmilione nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.**

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik Adenis Kastrati PF

L51611004I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. Operatori Ekonomik EUROPRINTY GROUP SHPK

L21621001I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik **Adenis Kastrati Person Fizik me numër NIUS L51611004I**

a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.3**,Kapaciteti Teknik,sipas shtojcës **nr.1 datë.12.03.2020** kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatori/et ekonomik **në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për të gjitha produktet e kërkuara vërtetim ose deklaratë ose autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit**, vërtetuar me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.*

*(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar **si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit**) .*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **Adenis Kastrati Person Fizik** është konstatuar se deklarata e paraqitur për produktet tonera nga **distributori i autorizuar prej prodhuesit është e pasaktë dhe jo e vërtetë**,konkretisht deklarata duhej të ishte e firmosur dhe vulosur nga shoqëria **ADD Print shpk** dhe jo nga vetë operatori **Adenis Kastrati Person Fizik**.

Gjithashtu, mungon edhe vërtetimi ose deklarata ose autorizimi nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit, për produktet e tjera sipas preventivit objekt prokurimi,konkretisht produktet **kancelarike**.

Referuar edhe ekstraktit historik ku në objektin e veprimtarisë midis të tjerave operatori ekonomik ka përcaktuar: Tregtim materialesh kancelarike, bojra per printera, servis printerash.Pra operatori nuk është prodhues i produkteve kancelarike dhe për plotësimin e kësaj pike duhet të paraqiste dokumentacionin e kërkuar justifikues dhe kualifikues.

b. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.4**,Kapaciteti Teknik, kandidati / ofertuesi duhej si më poshtë :

*Në datën dhe orën e hapjes së procedurës operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in mostra vetëm për **tonerat** sipas preventivit bashkëngjitur,pranë Bashkisë Kolonjë për procedurën“**Blerje Kancelari dhe Tонера viti 2020**”. Mostrat do ti kthehen ofertuesit , me kërkesën e tij 30(tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimitose pas nënshkrimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi ,sipas **nenit 27 pika 6 germa a të vkm nr.914 datë.29.12.2014**“ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ”e ndryshuar dhe të jenë identike në momentin e dorëzimit të të gjithë mallit.*

Referuar kërkesave për kualifikim **pika 2.3.4** operatori ekonomik nuk ka paraqitur në datën dhe orën e hapjes së procedurës mostra vetëm për tonerat sipas preventivit,pranë Bashkisë Kolonjë për procedurën e prokurimit Blerje Kancelari dhe Tонера viti 2020 .

c.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.5**,Kapaciteti Teknik,sipas shtojcës **nr.1 datë.12.03.2020** kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë **origjinale** pra të prodhuara nga e njëjta kompani që ka prodhuar dhe pajisjen ose ekuivalente me origjinalët të prodhuara për të funksionuar me paisjet që AK disponon.Në amballazh duhet të jetë stampuar marka e tonerave (**prodhuesit**) ku emri i prodhuesit të jetë edhe në pullën e sigurisë, vetëm për ato tonera që është e aplikueshme nga prodhuesi pulla e sigurisë. Të jenë të garantuara nga shiriti i sigurisë vetëm ato tonera që është e aplikueshme nga prodhuesi shiriti i sigurisë. Nuk duhet të jenë të rimbushura apo ricikluara.**Deklaratë nga operatori/et ekonomik për plotësimin e ketij kriteri**.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik

Adenis Kastrati Person Fizik është konstatuar se deklarata e kërkuar nuk është paraqitur.

d. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.8**,Kapaciteti Teknik, kandidati / ofertuesi duhej si më poshtë :

*Operatori/et ekonomik përveç ofertës ekonomike duhet të paraqesë dhe ofertën teknike ku duhet të përshkruajë markën dhe modelin vetëm për **tonerat** sipas preventivit bashkëngjitur.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **Adenis Kastrati Person Fizik** është konstatuar se oferta teknike e kërkuar nuk është paraqitur.

e.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.9**,Kapaciteti Teknik,sipas shtojcës **nr.1 datë.12.03.2020** kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

*Operatori/et ekonomik duhet të paraqes-in vetëm për tonerat dhe letrën A4 – A3 dokumenta teknike , **katalog ose skeda teknike**.Nëse këto dokumenta nuk janë në gjuhën shqipe ,duhet të paraqiten të përkthyer dhe noterizuara në ato pjesë që pasqyrojnë specifikimet teknike që kërkohen në dokumentave standarte të tenderit, sipas specifikimeve teknike. **Katalogu ose skeda teknike** të përmbajë karakteristikat teknike vetëm për tonerat dhe letrën A4 – A3 objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmëri e tyre).*

*(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar **si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit**) .*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **Adenis Kastrati Person Fizik** është konstatuar se katalogu teknik i kërkuar nuk është në gjuhën shqipe.Konkretisht specifikimet teknike janë në gjuhë të huaj ,të papërkthyer dhe të panoterizuar , duke e bërë të pamundur identifikimin e plotësimit të specifikimeve teknike.

Referuar nenit 14 pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) ku shprehimisht përcaktohet:

“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”, si dhe në dokumentat e tenderit, Seksioni 4 Procedura, **pika 4.6** është përcaktuar shprehimisht:

“Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Shqip **X** Anglisht

Tjetër _____

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1,nenit 53, të Ligjit Nr.9643,datë 20.11.2006,“Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme ofertën e operatorit ekonomik **Adenis Kastrati Person Fizik** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2.Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik EUROPRINTY GROUP shpk me numër NIUS L21621001I .

a.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 1,gërma b** , kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik rezultoi se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar të saktë deklaratën për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës

2/1,pasi tek **pika 6** nuk ka përcaktuar asnjë nga alternativat ,gërma **a** apo gërma **b**.

b.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 1,gërma dh** , kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik rezultoi se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar **vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri** ,pasi vërtetimi i dorëzuar nuk është i muajit të fundit . Operatori ekonomik ka dorëzuar vërtetim të muajit **Gusht 2019**.

c.Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.2 ; 2.3.3 ; 2.3.4 ; 2.3.5**,kapaciteti teknik sipas dokumentave standarte të tenderi dhe shtojcës **nr.1 datë.12.03.2020** , kandidati / ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë :

2.3.2.*Operatori/et ekonomik duhet të ofrojë/në garanci për mallin e ofruar si dhe ndërrimin nga difekte fabrikimi.Për permbushjen e kësaj pike operatori/et ekonomik duhet të paraqesë/in një deklaratë të nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor se në rast defektesh fabrikimi operatori merr përsipër zëvendësimin e mallit.*

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **EUROPRINTY GROUP shpk** është konstatuar se **deklarata** e kërkuar nuk është paraqitur.

2.3.3 *Operatori/et ekonomik në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për të gjitha produktet e kërkuara vërtetim ose deklaratë ose autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit , vërtetuar me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertuesit -distributor-prodhues, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.*

(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit) .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **EUROPRINTY GROUP shpk** është konstatuar se mungon **vërtetimi ose deklarata ose autorizimi nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit** , vetëm për **tonerat sipas preventivit**.

Referuar edhe ekstraktit historik ku në objektin e veprimtarisë midis të tjerave operatori ekonomik ka përcaktuar: Tregtia me shumice e makinave te zyrave dhe te pajisjeve informatike. Material kancelarike, printera,fotokopje,telefone,smartfone dhe aksesoret perkates.Tonera,material konsumi per paisjet informatike.Pra operatori nuk është prodhues i produkteve **tonera** dhe për plotësimin e kësaj pike duhet të paraqiste dokumentacionin e kërkuar justifikues dhe kualifikues.

2.3.4 *Në datën dhe orën e hapjes së procedurës operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in mostra vetëm për tonerat sipas preventivit bashkëngjitur,pranë Bashkisë Kolonjë për procedurën“Blerje Kancelari dhe Tonera viti 2020”. Mostrat do ti kthehen ofertuesit , me kërkesën e tij 30(tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimitose pas nënshkrimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi ,sipas nenit 27 pika 6 germa a të vkm nr.914 datë.29.12.2014“ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ”e ndryshuar dhe të jenë identike në momentin e dorëzimit të të gjithë mallit.*

Referuar kërkesave për kualifikim **pika 2.3.4** operatori ekonomik nuk ka paraqitur në datën dhe orën e hapjes së procedurës mostra **vetëm për tonerat sipas preventivit**,pranë Bashkisë Kolonjë për procedurën e prokurimit Blerje Kancelari dhe Tonera viti 2020 .

2.3.5 Tonerat për printerat dhe fotokopjet duhet të jenë origjinale pra të prodhuara nga e njëjta kompani që ka prodhuar dhe pajisjen ose ekuivalente me origjinalët të prodhuara për të funksionuar me paisjet që AK disponon. Në amballazh duhet të jetë stampuar marka e tonerave (**prodhuesit**) ku emri i prodhuesit të jetë edhe në pullën e sigurisë, vetëm për ato tonera që është e aplikueshme nga prodhuesi pulla e sigurisë. Të jenë të garantuara nga shiriti i sigurisë vetëm ato tonera që është e aplikueshme nga prodhuesi shiriti i sigurisë. Nuk duhet të jenë të rimbushura apo ricikluara. **Deklaratë nga operatori/et ekonomik për plotësimin e këtij kriteri.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **EUROPRINTY GROUP shpk** është konstatuar se **deklarata** e kërkuar nuk është paraqitur.

d. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, **pika 2.3.8, Kapaciteti Teknik,** kandidati / ofertuesi duhej si më poshtë :

Operatori/et ekonomik përveç ofertës ekonomike duhet të paraqesë dhe ofertën teknike ku duhet të përshkruajë markën dhe modelin vetëm për tonerat sipas preventivit bashkëngjitur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik **EUROPRINTY GROUP shpk** është konstatuar se **oferta teknike** e kërkuar nuk është paraqitur.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 46, pika 1, nenit 53, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall **të pavlefshme** ofertën e operatorit ekonomik **EUROPRINTY GROUP shpk** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik InfoSoft Office SHPK. me NIUS J62426002Q dhe adresë: Tiranë Kashar Koder Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8* , se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **1,911,267 (Njëmilionenëntëqindnjëmbëdhjetëmijë dyqindëgjashtëdhjetëeshtatë) leke pa tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë

Emri	Bashkisë Kolonjë
Adresa	Sheshi “ Rilindja ”
Tel/Fax	+355 812 2 2225 ; +355 812 2 3173
E-mail	bashkia.kolonje@gmail.com

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi , por jo me vone se **5 (pesë) ditë** nga marrja e kërkesës me shkrim për lidhjen e kontratës.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë : 31.03.2020**

Ankesa: **Jo**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ERION ISAI**